



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja r) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, Udhëzimin Administrativ nr.9/2010 për përgjegjësit dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të veprimit të Kosovës, nenet 16 dhe 19 shkronja r) të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, sipas kërkesës së KVRL – Podujevë nr.02-024/01-8863/17 të datës 09 shkurt 2017, në konsultim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nxjerr,

VENDIM

PËR NJOHJEN E KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL (KVRL) NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Bëhet Njohja e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, si organ i përfaqësimit rinor, i përbërë nga përfaqësuesit e Organizatave rinore jofitimprurëse të nivelit lokal.

Neni 2

Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, si formacion këshillues i organizatave rinore që veprojnë në nivelin lokal dhe përfaqësojnë interesat e organizatave rinore dhe të rinjve tek institucionet e pushtetit lokal, funksionin e ushtron në bazë të Ligjit nr.03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, Udhëzimit Administrativ 9/2010 dhe Rregulloren e miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit në Kosovë.

Neni 3

Këshilli i Veprimit Rinor Lokal sipas nenit 1 të këtij vendimi, vepron në territorin e Komunës së Podujevës, me qëllim të përfaqësimit të interesave të organizatave rinore tek institucionet komunale në Podujevë, si dhe ka përgjegjësi dhe obligim të fuqizoj Organizatat rinore të Komunës së Podujevës, për të ndërtuar një vizion të përbashkët për të rinjtë e Komunës së Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


I dërgohet:

- Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – Podujevë
- Këshillit të Veprimit Rinor Lokal – Podujevë

Nr.02-024/01-9809/17

Podujevë,

13 shkurt 2017



Kryetari i Komunës
Agim Veliu